



Nr. 1291 Rep.

Nr. 437/2 Kol.

## AKT THEMELIMI & STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA "GENERAL GREEN ENERGY" shpk, TIRANE

Sot me datë 20/12/2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), para meje Notere ALBANA XH. SPAHIU, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në Rr. H.H.Dalliu, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjiçësor Tiranë, u paraqit personalisht:

**Zj. BLERTA ABRIJA**, atësia Jorgji, lindur në Fier, ne date 23.10.1985 banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me anë të letërnjoftim me numer 032665257 dhe numër personal I56023052H.

**Z. PAULIN RAJTA**, atësia Ndue, i datelindjes 28/07/1964 lindur ne Krej Lure, Diber, banues ne Tirane, Rr. Haxhi Dalliu, identifikuar me Leternjoftimin me nr. serie 025081662 dhe nr. personal G40728097F, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

**Z.FLAMUR NDREKA**, atësia Selman, i datelindjes 25/01/1982 lindur ne Gryk Nok, Diber, banues ne Tirane, identifikuar me Leternjoftimin me nr. serie 025081662 dhe nr. personal G40728097F, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar

Te cilet me cilësinë e " Ortakut Themelues ", më kërkuan redaktimin e këtij Akti Themelimi & Statut, nëpërmjet të cilit deklaruan se, me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ", ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, "GENERAL GREEN ENERGY" shpk, Tiranë.

#### Neni 1 Krijimi

Shoqëria "GENERAL GREEN ENERGY" shpk, Tiranë, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

#### Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.  
Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.  
Shoqëria "GENERAL GREEN ENERGY" shpk, Tiranë, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.



**Neni 3**  
**Selia dhe Territori**


Shoqëria e do të ketë selinë në: Rr. Jordan Misja, Nd.42, H. 24, Ap.17, Njesia Administrative 9, Kod Postar 1016, Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Mbledhjes së Asamblese së Ortakeve.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë:

Shoqëri shërbimesh dhe aktivitete në sektorin e energjisë dhe ambientit ndaj personave fizike dhe shoqërive në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj: Tregtimi, projektimi, realizimi, ristrukturimi, instalimi, menaxhimi, drejtimi dhe përdorimi në mënyrë të zakonshme ose jo e impianteve për të prodhuar energji nga burime të rinovueshme. Shoqëria ka si projekt të aktivizojë dhe të drejtojë, në mënyrë direkte dhe indirekte, impiante për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme në sektorin civil, industrial, agrar, dhe për të tretet, edhe kur janë të destinuar totalisht ose pjesërisht, për ngrohjen dhe ngrohjen centralizuar si për llogari të vet apo të tjetër. Kryesisht shoqëria do të mund: të drejtojë, të kordinojë tipologji të ndryshme në baze të pikave më lart. Të ndermarre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të tjetër të tregut të gjitha aktivitetet të cilat lidhen me mirëmbajtjen e impianteve të caktuara më lart. Të përcaktohet tregu i materialeve, duke përfshirë mbetje të cilat kur riperdoren në këto mënyra janë të nevojshme për këto impiante. Të përcaktohet shitja ose shpërndarja e energjisë elektrike. Të aktivizohet dhënia ndaj të tregut, si publikë apo privatë, të shërbimeve që lidhen me drejtimin e energjisë edhe kur iu referohen zyra civile private dhe industriale. Të kordinohet studio e redaktimit të instrumentave administrative, teknike dhe urbanistike, në mënyrë që të merren autorizimet e duhura. Përcaktimin dhe ndermarrjen e strukturave të shërbimeve dhe produkteve të lidhur me rekuperimin dhe riciklimin e materialeve mbetje / skarco, mbetjeve e të tjerë ndaj subjekteve publike apo private dhe atyre industriale. Kryerjen e çdo aktiviteti që lidhet ngushtësisht me aktivitetet e mësipërme të përmendura, dhe përbashkja e çdo akti tjetër që ka si qëllim vazhdimësinë, ose konkluzionet e të gjitha operacioneve administrative, financiare dhe ekonomike të duhura dhe të nevojshme për realizimin e objektivave të përmendura. Zhvillimi i praktikave administrative të çdo lloji, ndermjetesime, konsulence, vleresime, aktivitete të një agjencie e cila funksionon në çdo sektor. Promovimi dhe pjesëmarrja në mundësi të ndryshme investimi që mund të paraqiten në çdo sektor të ekonomisë së vendit, duke u prezantuar si investitor i barabartë me subjekte të tregut, investitor i vetëm ose investitor mazhoritar me qëllim arritjen e objektivave ekonomike të shoqërisë dhe pjesëmarrjes në projektet me impakt social që diktojnë rritjen ekonomike të vendit dhe standartet e tij të jetesës. Shoqëria mund të zhvillojë aktivitete shërbimi, çdo tip operacioni ose investimi në sektorin e pasurive të luajtshme, të pasurive të paluajtshme, financiare, tregtare, lëshimin e garancive, garanci dhe koncesione hipotekore, duke përfshirë edhe hyrjen ose marrjen pjesë në çdo formë, në formën e konsorciumit, në një sipërmarrje të përbashkët, joint venture, në sipërmarrjet e përkohshme të përbashkëta dhe konsorciume, në kompani të tjera që kanë objekt të ngjashme shoqërore ose plotësuese. Shoqëria mund të kontrakttojë kredi dhe në përgjithësi të kërkojë çdo formë të financimit me bankat, me shoqëri dhe individë me garancitë e përshtatshme mobiliare dhe pasurive të paluajtshme, reale dhe personale. Shoqëria mund të aplikojë ndaj çdo forme të financimit dhe / ose kontributeve nga karakteri kombëtar dhe nderkombëtar. Procesi i përzgjedhjes për rekrutimin e stafit dhe organizimin e kurseve të informacionit, edukimit dhe trajnimit. Aktiviteti i marketingut strategjik dhe operacional dhe hulumtimit të tregut; kërkimi dhe zhvillimi. Duke marrë përfaqësim, mandate, të deleguara për llogari të shoqërisë tregtare, industriale, ushqimore dhe shërbimeve në përgjithësi duke marrë pozicione brenda sferës së ndermjetesimit tregtar. Me vendim të organit kompetent, shoqëria mund të zotërojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndermarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.





Import-Eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të karburantit (naftë, benzinë, vajguri etj.), si dhe vajra lubrifikante e materiale të tjera për automjete. Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të pompave për karburante. Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjithë materialeve dhe pajisjeve elektrike, produkteve ushqimore e industriale, të prodhimeve bujqësore,blektorale e elektroshtepiake. Tregtimin e produktit të lëndës djegëse Gaz. Shitje mallra të ndryshme me shumicë dhe pakicë, eksport, import, shërbime të ndryshme. Prodhim, paketim detergjentësh me shumicë dhe pakicë, import dhe pakicë, import - eksport fruta perime me shumicë dhe pakicë. Tregtim tekstilësh, konfeksione, rroba të përdorura, manifaktura, prodhime lëkure, këpucë, canta, rripa etj....brenda dhe jashtë vendit.

Ndërtim, projektim, zbatim, supervizion, punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, ndërtime civile, objektesh të ndryshme, ura, ndërtime rruge te kategorive te ndryshme, hekurudhore, asfaltim, ndërtime vepra arti të vogla, ndërtime ujësjellësash, kanalizime, rikonstruksione godina civile, ushtarake, ekonomike, veshje fasadash, elemente te parafabrikuara betoni /betonarme, instalime te nevojshme. Prega beton armeje e metalike, punime karpenterie, pastrim te siperfaqes urbane etj.

Në fushën e shërbimit të transporteve (tokësor, hekurudhor, ajror, telekomunikacioni) transferta financiare, sigurim e shërbime të tjera, punime elektrike, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimorë, industrialë, pije freskuese, alkolike të të gjitha llojeve, konfeksione veshmbathje, metrazhe të ndryshme, automjete tipe dhe marka të ndryshme dhe pjesë ndërrimi të të gjitha llojeve, import - eksport të artikujve të ndryshëm,industrial,etj. Riparim stampa plastike, prodhim dhe fryrje shishe plastike.

Punime ne bujqesi, Tregti te farave bujqesore, plehra kimike dhe pesticide. Farmaci bujqesore, tregtim farash, prodhim dhe tregtim fidanesh, mbjellje, kultivim. Hartimi i planeve te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave, hartimi i projekteve te pyllzimit, trajtimit te pyjeve, shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve, ndertim i rrugeve pyjore, studime fitopatologjike-entomologjike dhe zjarreve ne pyje, studim e menaxhim te perdorimit te territorit. Pyllzim, permiresim pyjesh, shfrytezim i qendrueshem i pyjeve, sistyemime malore, vjelje dhe grumbullim i produkteve bujqesore, ndertim / meremetim i veprave te ujit te pijshem ne kullota e livadhe. Agjensi komisionesh, transport udhetaresh si brenda ashtu dhe jashte territorit te vendit

#### **Neni 5 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

#### **Neni 6 Kapitali themeltar**


Kapitali themeltar i shoqërisë është i perbere nga kontributi ne para i ortakeve nw vleren 100,000 Lek dhe është i ndarë në 3 pjese, kete menyre:

1. **Zj. Blerta Abrija - 1 kuote me vlere 33,000 Lek (tridhjete e tre mije), te barabarte me 33% te kapitalit themelues.**
2. **Z. Paulin Rajta - 1 kuote me vlere 33,000 Lek (tridhjete e tre mije), te barabarte me 33% te kapitalit themelues**
3. **Z.Flamur Ndreka -1 kuote me vlere 34,000 Lek (tridhjete e kater mije), te barabarte me 34% te kapitalit themelues**

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 100,000Lek, që përbën 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Ortakët, ne baze te kerkeses se organit administrues mund te sjellin para ne shoqeri sipas marreveshjes paraprake te lidhur me tyre. Kjo derdhje mund te behet ne formen e zmadhimit te kapitalit dhe/ose ne formen e financimit te shoqerise. Ne rastin e financimit nga ortakët ne forme huaje, nuk nevojitet perpjesshmeria mes shumes se derdhur ne shoqeri dhe kuotave te kapitalit qe ortakët zoterojne.





## Neni 7

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e 3/4 (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

Nese ndonjeri nga ortaket nuk do te nenshkruaje kuoten e tij te kapitalit ne zmadhim, e drejta e opsonit do ti perkase ortakeve te tjere. Duke mos e ushtruar ortaket të drejtën e opcionit, kapitali në zmadhim i panënskruar do te nënskruhet nga palë të treta.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme, në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabel të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakeve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Përgjegjësia e ortakeve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

Kuotat e kapitalit të shoqërise nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.

Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesemarrjes ne kapital.

Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojne dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

## Neni 8

### Pasuria e Shoqërise

Shoqëria behet pronare e pasurise se luajtshme apo te paluajtshme kur vlera e pasurise mbulohet teresisht ne te holla.

## Neni 9

### Transferimi i kapitalit

- Kapitali themeltar ose Pjesë të tij mund të trasferohen lirisht mes ortakeve të shoqërise.  
- Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refiizuar ushtrimin e të drejtës së parableijes. Transferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjeseve te tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyre:


-Oferta per shitje u drejtohet te gjithe ortakeve me shkrim ose mjete elektronike;

-Oferta duhet te percaktoje numrin e kuotave qe shiten dhe çmimin e tyre;

Nese ortaket e shoqërise brenda 30 dite nga oferta me shkrim (te saktuesuar me fletemarrjen postare) nuk pranojne blerjen e kuotave te ofruara me çmimin e percaktuar, atehere konsiderohet se ata lejojne shitblerjen tek te tretet.

nese me shume se nje nga Ortaket shpreh deshiren per te ushtruar te drejten e parablerjes se kuotes se kapitalit ne shitje, kuota do te ndahet ne menyre te perpjesshme me kuotat ekzistuese.

- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Bashkshorti, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar sipas kushteve qe lejohen ne ligj. Kuotat janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet para-ardhësve dhe pas-ardhësve.





- Kuotat e kapitalit mund të transferohen në mënyrë të lirë përmes dhurimit (falas).
- Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt noterial dhe të depozitohen në organin kompetent.

**Klauzolë miratimi.** Nëse asnjë ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes në kohë dhe sipas kushteve të parashikuara për transferimin e kuotave apo të drejtën e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese së Ortakeve që vendos për pranimin e transferimit të një personi i tretë. Ortaket mbledhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nëpërmjet Asamblese të Zakonshme të Ortakeve, duke vendosur me votën pro (në favor) me të paktën gjysmën e kapitalit themeltar.

Pëlqimi mund të refuzohet vetëm kur blerësi nuk jep garanci të mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive o për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqëria ose konflikti me interesat e shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Asambleja e Ortakeve duhet të njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkues që nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhënë dhe ortakët mund të transferojnë kuotën e tyre.

Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakeve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

### **Neni 10 Konfidentaliteti**

Ortakët e shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

### **Neni 11 Dokumentet e destinuarat për të tretët**

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuarat për të tretët, si letrat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshem emrin e shoqërisë dhe pas tij inicialet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "shpk", si dhe emrin e administratorit ose të administratorëve.

### **Neni 12 Organi Vendimmarres**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësojë shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotëruar të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë do t'i referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

Shoqëria mund të emerojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar Administratorin e shoqërisë, ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

Përveç organeve të parashikuara me sipër Asambleja e Ortakeve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezagjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare është **Zj. Blerta Abrija**. Ajo mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

### **Neni 13 Vendimet e asamblese**

Asambleja e Ortakeve vendos për çështjet që ligji apo ky statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

#### **KUORUMI:**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e



numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### VENDIMMARRJA:

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr.9901, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin nr. 9901 ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo ortak ka të drejtën e një vote për çdo kuote të kapitalit themeltar të shoqërisë që ai zoteron. Një ortak mund të përfaqësohet në mbledhjen e asamblese nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, nepermjet një akti përfaqësimi me shkrim.

### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Asamblese se Ortakeve**

Asambleja e Ortakeve mund të jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo në varesi të çështjes për të cilën është thirrur.

Vendimet e Asamblese se Zakonshme të Ortakeve merren me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme të Ortakeve merren me një shumicë të cilesuar prej 3/4 (tre të katërtave) të votave të ortakëve të shoqërisë. Për çfarë nuk është pasqyruar në këto nene, Asambleja e Ortakeve të shoqërisë vendos në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008.

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme të Ortakeve do të jene:

- Vendos për përpilimin ose miratimin e rregulloreve për shoqërinë apo për fusha të veçanta të veprimtarisë.
- Vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë.
- Vendos për krijimin e zyrave ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive ose të ortakëve me persona të tjerë fizike apo juridike.
- Vendos për politiken afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- Emeron dhe shkarkon Administrators të shoqërisë, ekspertin kontabel, likuidatori duke përcaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, të drejtat, detyrimet, kohezigjatjen në detyrë, dhe shpërblimin e tyre.
- Vendos në lidhje me krijimin e organeve të tjera drejtuese që mund t'i nevojiten shoqërisë duke përcaktuar në aktet e krijimit të këtyre organeve, kohezigjatjen dhe kompetencat e tyre, për emerimin e personave drejtues të këtyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve të kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes të asnjë organ tjetër. Asambleja e Ortakeve vendos edhe në lidhje me krijimin e sektoreve të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifën e shërbimeve të shoqërisë.
- Miraton pagat e të punësuarve në shoqëri.

Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme të Ortakeve janë:

- Vendos në lidhje me zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Vendos në lidhje me kohezigjatjen e shoqërisë si dhe për mbarimin e likuidimit të saj.
- Vendos për ndryshimin e emrit të shoqërisë.
- Vendos në lidhje me ndryshimin e statutit të shoqërisë.
- Vendos për ndryshimin e formës, për ndarjen e shoqërisë si dhe për bashkimin e saj me shoqëri të tjera.
- Përcakton llojin e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, përcaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marrëdhëniet me të rendesishme ekonomike dhe financiare të shoqërisë me persona të tjerë fizik apo juridik, vendas apo të huaj.
- Vendos në lidhje me transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë. 20.4Përveç

kompetencave të lartpërmendura, të cilat janë ekskluzive për të,





Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence që ia njihet ligji.

Asambleja e Ortakeve në rastet kur nuk ka emëruar Administrator, kryen dhe kompetencat që në këtë Statut janë përcaktuar për këtë të fundit. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve mund të kufizojë Administratorin në ushtrimin e kompetencave të tij

### Neni 15

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e asamblese së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Mbledhja e përgjithshme thirret nga administratori/Administratores apo ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulon detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- konstatohet se ortakët që kanë patur detyrime ndaj shoqërisë nuk i kanë realizuar ato sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar
- Në çdo rast tjetër që e kërkon ortakët që zotërojnë të paktën 10 % të kuotave të kapitalit.

Ortakët vendosin mbi temat që ligji dhe statuti i japin të drejtën të vendosin

Vendimet e ortakëve mund të merren nëpërmjet:

- a) vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në mbledhje të zakonshme;
- b) këshillimit me shkrim

Procedura për marrjen e vendimit nëpërmjet këshillimit të shkruar, rregullohet si në vijim :

- a) Njëri nga ortakët apo administratorët u komunikojnë të gjithë Ortakëve dhe të gjithë Administratorëve që nuk janë ortakë, tekstin e vendimit që propozohet të merret, duke fiksuar një afat jo më të shkurtër se 5 ditë, brenda të cilit secili prej Ortakëve mund t'i komunikojë shoqërisë miratimin, abstenimin apo votën kundër. Në rast se afati i caktuar është plotësuar dhe Ortaku nuk është shprehur, miratimi konsiderohet se nuk është dhënë.
- b) Nga dokumentet duhet të duken me qartësi argumentet që janë objekt i vendimit dhe miratimi i tyre.
- c) Komunikimet e parashikuara nga artikujt e mësipërm a) dhe b) mund të bëhen nëpërmjet çdo mjeti dhe/ose sistemi komunikimi që lejon një provë të nisjes dhe të marrjes së komunikimit, duke përfshirë këtu faksin dhe postën elektronike. Në rastet e fundit, transmetimet ndaj Ortakëve duhen bërë në numrin e faksit dhe/ose adresën e postës elektronike që janë komunikuar në mënyrë të qartë nga vetë Ortakët.

### Neni 16

#### Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Mbledhja e Asamblese së Ortakeve.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### Neni 17

#### Administrimi

Administrator/Perfaqësues Ligjor i shoqërisë do të jetë Zj. Blerta Abrija, për një afat prej 5 vjetësh. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Mbledhjes së Asamblese së shoqërisë.



## **Neni 18** **Kompetencat**

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratores, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdoq formë qoftë, të marrin hua tek shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorezues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

## **Neni 19** **Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortakut i vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakut ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortakut ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortakut që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

## **Neni 20** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 21** **Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur edhe humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## **Neni 22** **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.



**Neni 23**  
**Bilanci Kontabël**

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetëm, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimitarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj.

**Neni 24**

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

**Neni 25**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë dhe për çfaredo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jene:

- a- Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimitarisë së saj.
- b- Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare"
- c- Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimitarisë tregtare.

Në këtë rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri ne likuidim e sipër".

**Neni 26**

**Bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i vetem i shoqërisë, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme. Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërisë që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj tek shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

**Neni 27**

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne QKR.

**Neni 28**

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

**Neni 29**

**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe Shoqërite Tregtare, Ligji për QKR, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 30

#### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### Neni 31

#### Dispozita perfundimtare

Ky Akt Noterial, u redaktua ne 5 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "GENERAL GREEN ENERGY" shpk, Tiranë, nënshkruhet rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

Palet deklarojne se kanë dhënë pëlqimin e tyre, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", pra për trajtimin e tyre nga unë noterja, se dhe per gjenerimin dokumentacionit te nevojshem nga portali shteteror e-albania.

#### Ortaket

#### Zi. BLERTA ABRIJA

*Blerta Abrija*

#### Z.FLAMUR NDREKA

*Flamur Ndreka*

#### Z. PAULIN RAJTA

*Paulin Rajta*

#### NOTERE

Albana XH. SPAHIU



*Albana Spahiu*